

VENDIM
Nr. 9, datë 28.2.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence " Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Korçë me:
Drejtues Ligjor Petrit Tare
Drejtues Teknik Pandi Qirinxhi
Drejtues Teknik Arlinda Ibrahimllari
2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Korçë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
Kategoria D - Për përpunimin e ujërave të ndotura
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Korçë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

KRYETARI
Ndriçim Shani